




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHËTË
Komiteti për Komunitete
Nr.01-060/01-12966/22 datë: 24.05.2022



Npi – 01/128 datë: 27.05.2022

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 27.05.2022, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -II- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE
E mbajtur më: 27.05.2022 (e premte) në ora 14.00 h. në sallën e Kuvendit.

Në mbledhje përveq anëtarëve të Komitetit për Komunitete: Besnik Seferi, Shkurte Mustafa, Rrezartë Ramadani, Muhamet Mehmeti, Shkurte Behluli, Arton Demiri, Bajram Ilazi, kanë marrë pjesë edhe: Kryesuesi i Kuvendit z.Adnan Ademi, Zyrtari për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore z.Reshat Gashi, Praktikantja, znj.Valmira Hoxha.
Mbledhjen e hapi Kryesuesi i Komitetit z.Bajram Ilazi i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK më 27.04.2022,
2. Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPK për 2022,
3. Zgjedhja e komisionit për hartimin e Planit të Punës për vitin 2022,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika I

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e KPK më 27.04.2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Besnik Seferi; Përshendetje, kam vërejtje te pjesa e diskutimit tim, mu duk pak e shkurtë. Herave të tjera duhet të shënohet saktë. Meqenëse takimi i pare i Komitetit është shumë i rëndësishëm ka qenë dashtë me i shënuar. Mirë që u diskutua për pyetjet sepse unë kamë thënë, se më mire është me i bërë pyetjet me shkrim.

znj.Rrezartë Ramadani; Unë po e përmendi se edhe mua nuk më është shkruar diskutimi.

*** Komiteti për Komunitete, me 6 vota "Për" me 0 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi Ekstrakt Procesverbalin nga mbledhja më 27.04.2022.**

Pika 2

Propozim-Vendim për caktimin e orarit të mbledhjeve të KPK për 2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

Komiteti për Komunitete, unanimisht aprovoi Vendimin për caktimin e orarit të mbajtjes së mbledhjeve për vitin 2022.

Pika 3

Zgjedhja e komisionit për hartimin e Planit të Punës për vitin 2022

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Para se të hapi diskutimin për këtë pike, po pres propozimet se a po e bëjmë Komisionin prej 3 apo prej 5 anëtarëve.

* Komiteti për Komunitete, me 4 vota "Për" me 2 vota "Kundër" dhe me 1 votë "Abstenim" miratoi vendimin që Komisioni të jetë i përbërë prej 3 anëtarëve.

z.Besnik Seferi; Unë propozoj, Shkurte Mustafa,

z.Arton Demiri; Unë e propozoj, Muhamet Mehmetin,

znj;Rrezartë Ramadani; Unë e propozoj Bajram Ilazin,

z.Muhamet Mehmeti; Unë e propozoj Benik Seferin.

z.Besnik Seferi; Unë isha për tre anëtarë, nuk e di se sa muj me kontribuar, kështu që unë po tërhiqem le të mbesin tre anëtarët e propozuar.

* Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -II- për vitin 2022, të mbajtur më: 27.05.2022, unanimisht, zgjodhi Komisionin për hartimin e Planit të Punës të Komitetit për vitin 2021, prej 3 anëtarëve si vijon: Bajram Ilazi, Muhamet Mehmeti, Shkurte Mustafa.

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Unë propozoj që Plani I p[unës të përfundohet deri më 20 Qershor. Po ashtu propozoj që më datën 10.06.2022 në ora 15h të takohemi anëtarët e Komisionit për hartimin e draft planit të punës së Komitetit.

* Komiteti për Komunitete në mbledhjen e -II- për vitin 2022, të mbajtur më: 27.05.2022, unanimisht, vendosi që më datën 10.06.2022, në ora 15.00h të takohet Komisioni për hartimin e draft planit të punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2022.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi i Komitetit, z.Bajram Ilazi; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Mehmeti; E përgëzoj Kryetarin Aliu, për projektin në vlerë prej 70 mijë eurove për ndërtimin e një parku, mirëpo unë po kërkoj tra di se pse parku ka shkuar në Davidovc e jo në fshatrat tjera që ka nevojë më shumë si psh. në fshatin Gjyrkovc.

Kryesuesi i Kuvendit, z.Adnan Ademi; Ky projekt është bërë në Davidovc për shkak të hapsirës më të madhe që dmth. ka pas hapsirë të mjaftueshme për realizimin e tij, ndërsa në fshatrat tjera me komunitete nuk ka pas hapsirë të mjaftueshme, kjo është arsyeja. Komuna e Shtimes sa e di unë ka fituar 2 projekte për në fshatin davidovc dhe tjetri do të ishte mire për fshatin Gjyrkovc, dhe mendoj se do të ishte mirë që të diskutohet në Komitetin për Komunitete.

z.Arton Demiri; Edhe unë e përkrahu mendimin e Mehmetit.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Ne në vazhdimësi jemi në kërkim të projekteve për komunitetin pakicë. Unë i adresoj projektet, por prap Komiteti për Komunitete duhet në mënyrë të qartë ti adresojë të gjitha çështjet e Komunitetit pakicë.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi mbledhjen e Komitetit e përfundoi në ora 14.34 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Bajram Ilazi